



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:271289
Datë: 07.03.2024
Numri i dokumentit: 05421162

C.nr.1634/23

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Fuad Haliti, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B.V nga Mitrovica të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokat Uvejs Gashi, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore, me objekt kontesti kompensim i shtesave në pagë në emër të licensimit, jashtë seance me datë 07.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET se është tërhequr padia me numër **C.nr.1634/23** e paditëses B.V nga Mitrovica të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokat Uvejs Gashi, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore, me objekt kontesti kompensim i shtesave në pagë në emër të licensimit,

Arsyetim

Paditësja B.V nga Mitrovica me datën 27.11.2023 nëpërmes të autorizuarit të saj avokat Uvejs Gashi, pranë kësaj gjykate ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore, për kompensimin e shtesave në pagë në emër të licensimit.

I autorizuari i paditëses me parashtrësën e datës 15.01.2024 ka njoftuar gjykatën se e tërheqin padinë në këtë çështje kontestimore.

Në bazë të nenit 261 paragrafi 1 i LPK-së parashihet që *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi.”*

Andaj gjykata duke u bazuar nenit 261 paragrafi 1 i LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil
C.nr.1634/23, datë: 07.03.2024

Gjyqtari
Fuad Haliti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.